



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosovo - Republic of Kosovo**  
**Kuvendi - Skupština - Assembly**

---

**Legjislatura VI**

**Sesioni pranveror**

**Komisioni për Administratë Publike, Qeverisje Lokale dhe Media**

Mbledhja nr. 29

Prishtinë, më 25 korrik 2018, në orën: 10:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla N-10

**Procesverbal**

Në mbledhje morën pjesë: Nait Hasani, Shqipe Pantina, Valon Ramadani, Adem Mikullovc, Imet Rrahmani, Arban Abrashi, Xhevahire Izmaili, Rasim Selmanaj dhe Milaim Zeka.

Munguan: Jasmina Zhivković dhe Albert Kinolli.

Në mbledhje morën pjesë përfaqësuesit e OSBE-së, KDI-së, INPO-s, “Ekonomia Online”, “KosovaPress”.

Nga stafi mbështetës i komisionit: Drita Morina dhe Mirjeta Heta.

Mbledhjen e kryesoi: Nait Hasani, kryetar i komisionit.

**Rend i ditës:**

- 1. Miratimi i rendit të ditës;**
- 2. Miratimi i procesverbaleve të mbledhjeve të komisionit;**
- 3. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 06/L-043 për lirinë e asociimit në organizata joqeveritare;**
- 4. Të ndryshme.**

**1. Miratimi i rendit të ditës**

Rendi i ditës u miratua pa ndryshime.

**2. Miratimi i procesverbaleve të mbledhjeve të komisionit**

Procesverbalet u miratuan pa vërejtje.

**3. Shqyrtimi i Projektligjit nr.06/L-043 për lirinë e asociimit në organizata joqeveritare**

Komisioni vazhdoi me shqyrtimin e Projektligjit për OJQ-të dhe hartoi propozim - amendamente si vijon:

#### **Propozim-amendamenti 1**

**Neni 38, paragrafi 7**, fshihen fjalët: “nëse këtë e ka imponuar një situatë e”, zëvendësohen me fjalët “në raste të”.

#### **Propozim-amendamenti 2**

**Neni 38, paragrafi 10**, pas fjalës “Departamenti”, shtohen fjalët: “dhe OJQ-ja”.

#### **Propozim-amendamenti 3**

**Neni 39, paragrafi 3**, fshihen fjalët: “tatimore dhe doganore të papaguara që kanë rrjedhur nga lehtësirat tatimore dhe doganore sipas Statusit për Përfitim Publik”, zëvendësohen me fjalët “sipas legjislacionit në fuqi”.

#### **Propozim-amendamenti 4**

**Neni 39, paragrafi 5**, mbetet si në projektligj.

#### **Propozim-amendamenti 5**

**Neni 40, paragrafi 1**, fshihen fjalët: “për të cilin i ka gëzuar këto lehtësira që i ka garantuar statusi për përfitim publik”.

#### **Propozim-amendamenti 6**

**Neni 40, paragrafi 6**, mbetet si në projektligj.

#### **Propozim-amendamenti 7**

**Neni 41, paragrafi 2**, riformulohet si vijon: “ Në rast të shuarjes së OJQ-së, pasuria e mbetur pas shlyerjes së obligimeve të OJQ-së, i bartet OJQ-së tjetër të regjistruar në Republikën e Kosovës ose institucioneve tjera, me qëllime të njëjta apo të ngjashme”.

#### **Propozim-amendamenti 8**

**Neni 41, paragrafi 3**, fshihen fjalët: “OJQ përfituese”, zëvendësohen me fjalët: “OJQ ose institucioni përfitues”.

#### **Propozim amendamenti 9**

**Neni 41, paragrafi 4**, mbetet si në projektligj.

**Propozim-amendamenti 10**

**Neni 47, paragrafi 3**, fshihet.

Mbledhja përfundoi në orën:12:05.

**E përgatiti:**  
**Stafi mbështetës i komisionit.**

**Kryetari i komisionit,**

-----  
Nait Hasani